

May 2, 1962

Report on Reiz Malile's Ambassadorial Credentials Sent to the DRV and his Discussions with the DRV Leaders

Citation:

"Report on Reiz Malile's Ambassadorial Credentials Sent to the DRV and his Discussions with the DRV Leaders", May 2, 1962, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh V. 1962 D. 231 <https://digitalarchive.umd.edu/document/110162>

Summary:

The new ambassador to China and to the DRV, Reiz Malile, reports on his meetings with Vietnamese leaders during his visit to Vietnam on 14 - 28 of April 1962. Malile states that he met DRV President Ho Chi Minh, the Prime Minister of the DRV, Fam Van Dong, Minister of Foreign Affairs for the DRV, Ung Van Khiem, and 1st Secretary of the Central Committee of the Working Party of Vietnam, Le Duan. In his discussions, they support the Albanian government's stance on Khrushchev and the Soviet leadership in general. Meanwhile, the Vietnamese leaders avoid discussions targeted against the Soviet Union and, instead, propose the need for unity in the international communist movement. They also ask to stop the polemic in the media in order for the other bloc not to profit from the internal disputes of the communist camp. According to Malile, among the Vietnamese leadership there is a strong spirit not to cause a break with the Soviet Union. Malile claims that the Vietnamese communists are not fully informed on Albanian-Soviet disputes, which they view as simple disagreements between brothers. According to Malile, there is a great deal of Chinese and Soviet propaganda concerning the political international situation that presents differing points of view.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

Viti:
Dosja#

DEKLASIFIKUAR

Viti:
Dosja# Fleta:

XXVIII / 1 / 9

Vietnam
01-73P. Per 8
466-1



AMBASADA E R.P. TE SHQIPERISE
PEKIN

Pekin, me 2 maj 1962

Bii-8
Vietnam

Nr. 129 t.sekret.

bi de kellyjsh
in

Komitetit Qendror te P.P.
Ministrise se P.te Jashteme

TIRANE

Bashkengjitur ju dergojme nje informacion mbi viziten
qe beri Titullari i kesaj Ambassade ne R.D.te Vietnamit me rastin
e dorezimit te leter kredencialeve. Relacioni permban te dhenat
mbi bisedat e zhvilluara me shoket usheheqes vietnameze si dhe
njofitime te tjera.

Me posten e pare do t'ju dergojme edhe dy informacione
te tjera plotesuese mbi qendrimin e Titullarit ne Vietnaam, nuk
patem mundesi t'ia u nisim kete radhe per arsye per arsye se
posta diplomatike me shokeve kineze niset shpejt.

Ambasadori
(Reis Malile)

R. Malile

Lidhje:ll flete.



MPJ ARKIVI

Viti:

Dosja: Flet:

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI

Viti:
Dosja: Fleta:8
2

Relacion mbi dorezimin e leter kredencialeve
nga ana e sh.R.Malile ne R.D.te Vietnamit
si dhe mbi bisedat e zhvilluara me kete
rast me shoket usheheges vietnameze

Ne baze te udhezimeve te Ministrise, me 14 prill 1962, shkova ne Hanoi per dorezimin e leter kredencialeve. (Shenoi se udhetimin deri ne Juge te Kines e bera se bashku me trupin diplomatik te akredituar ne Kine, per te cilin Ministrija e puneve te Jashteme te Kines kishte organizuar nje ekskursion n'ate zone. Ne daten e siper permendur une shkova ne Vietnam ndersa diplomatat e tjere vazhduan ekskursionin ne zonen veriore).

Ne stacionin hekur-udhor te Hanoit u pritja nga shefi i Protokollit te Ministrise se Puneve te Jashteme, nga Ambasadori i Koreses qe eshte dhe duajen i trupit diplomatik, i ngarkuari me pune a.i. i Kines, nje sekretar bullgar, Konsulli pergjitheshem i Indonezise, perfaqesuesi Qeverise Francese dhe perfaqesuesi i Qeverise se Laosit. Titullaret e vendeve te tjera socialiste, per arsye qe dihen, nuk kishen dale ne pritje. Me pas vetem ambasadori bullgar me kerkoi ndjese qe nuk mundi te vinte ne stacionin e trenit per "arsye se ishte i zene ne nje mbledhie".

Me te zbritur ne stacion shefi i Protokollit me njoftoi se gjate qendrimit ne Vietnam ishem miq te pales se tyre dhe per kete tha "kemi udhezime nga lart". E falenderova per kujdesin e rastit.

Me 16 prill 1962 bera vizite shefit te Protokollit, (15 prill ishte e diel). Ky me njoftoi se leter kredencialet do t'ia dorezoj Zv. Presidentit te Vietnamit shokut Tom Duc Thang mbassi "keshtu ishte praktika e tyre" dhe, per larguar dyshimet, me shpjegoj se "shoku Tom Duc Thang eshte shume i njohur ne Vietnamin e Jugut, perpiqemi ti rrisim autoritetin edhe me shume atje. Ai eshte revolucionar i vjeter dhe ka marre pjese ne kryengritjen e flotes se Detit te Zi se bashku me Andre Marti, etj. Natyrisht une nuk ia zgjata.

Po ate dite i bera vizite Ministrit te Jashtem shokut Ung Van Khiem, te cilit i dorezova kopjet e leter kredencialeve si dhe te fjalimit qe do te mbaja. (Lidhur me dorezimin kredencialeve Zv. Presidentit pyeta shoket kines

Viti:
Dosja:

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:8
3

-2-

ne nje takim mbas dorezimit te kredencialeve dhe me tha, se "ashtu ishte praktikuar edhe here te tjera".

Fjalimin e mbajtur nga ana teme me kete rast, ne e kishem pregatitur shume te ngrohet dhe te forte ne denoncimin e imperializmit amerikan. Fjalimi i tyre ishte shume i shkurter, jo me te njetin tone te ngraste si toni, veç kesaj karakteristike eshte se nuk kishte asnje fjale kundra imperializmit amerikan qe ka pushtuar gjysmen e Vietnamit. Ne shtypin e tyre, te nesermen e dorezimit te kredencialeve, ata botuan ne faqen e pare nje pjese te fjalimit ku denoncohej imperializmi amerikan nga ana tone, pjesen e fjalimit te tyre ku flitej mbi sukseset e popullit tone nen udheheqien e drejte te Partise se Punes, si dhe nje fotografi nga ceremonija e rastit. Ne te njejten date organi i Partise se Punonjesve te Vietnamit botonte dhe nje artikull me nje fotografi mbi realizimet ekonomike ne vendin tone.

Ne Vietnam qendrova gjithesej dy jave. Gjate kesaj kohe iu bera vizite shokeve qe vijojne: Shokut Ho Shi Min, shokut Le Zhuen, Sekretar i pare i KQPPV; Kryeministrit shokut Fam Van Dong; Zv. Kryeministrit dhe antarit te Byrose politike sh. Lue Zhue Cin, (Delegat i P.P. Vietnamit ne Kongresin e Katert te Partise tone); Presidentit te Asamblese Popullore; Ministrit te Kultures; Ministrit te Arsimit; Ministrit te Tregetise se Jashteme; Ministrit te P. te Jashteme; Kryetarit te Komitetit Ekzekutiv te Qytetit te Hanoi; Zv. Ministrit te Puneve te Jashteme; Zv. Ministrit te Komunikacionit (me kete bisedova mundesite e ardhies ne Haifong te vaporeve tane); Zv. Presidentit te Komitetit per maredhenie kulturele me boten e jashteme, (Presidenti nuk ndodhej ne Hanoi); si dhe disa kryetareve te degeve te Ministrise se Puneve te Jashteme. Gjate ashtu iu bera vizitat e rastit kolegeve te trunit diplomatik Po ne kete kohe, per dy dite, shoket vietnameze organizuan nje vizite deri ne qytetet Haifong dhe Ho gai, ku vizitova nje miniere qymyri si dhe portin e Haifongut.

Gjate qendrimit ne Hanoi, Ministri i Puneve te jashteme shoku Khiem dha nje darke zyrtare. Veç kesaj kudo qe shkova per vizite u prita nga ana e shokeve drejtuse te qytetit si dhe te qendrave te punes perkatese. Per

./..

Viti
Dokumenti

I DEKLASIFIKUAR

-3-

MPJ ARKIVI
Viti;
Dokumenti Fleta:10
4

bisedimet e zhvilluara ne takimet e sipërme si dhe pershtypiet e rastit ne forme permbledhese po shkruajme me poshte.

x

x

x

I. Mbi bisedimet me shoket udheheqes vietnameze:

1.-Shoku Ho Shi Min me priti ne takim me 21 prill 1962, ora 18,45. Ne takim asistonte dhe shefi i Protokollit te Ministrise se Puneve te Jashteme. Ne fillim e pershendeta shokun Ho Shi Min ne emer te shokut Enver, te shokut Mehmet dhe te udheheqesve te tjere te Partise dhe te popullit tone. Ai u interesua per shendetin e shokut Enver dhe i dhashe pergjegjien e rastit. Me pas me kerkesen e tij e informova shkurter mbi gjendien ne vendin tone mobilizimin e masave punonjese per realizimin e planit dhe arrita ne problemet politike. I thashe se Partija tone qmon shume perpjekjet e sigjerta te Partise se Punonjesve te Vietnamit per ruajtjen e unitetit. Doja te vazhdoja per ta informuar mbi marredheniet me Bashkimin Sovietik por ai me preu fajlen dhe tha se "kjo eshte detyra tone, nga ana tone ne nuk thomi as kush ka gabim as kush ka te drejte. Tani ne kemi nevojte te domosdoshme per unitetin, na nevoitet medoemos uniteti pse, nga kjo situatë, po perfitojne shume armiqte".

Iu pergjegja se Partine tone e preokupon seriozisht kjo gjendie e se ajo ka bere dhe po ben gjithë perpjekjet e duhura per sigurimin e unitetit mbi baza te shendosha. Pas kesaj shoku Ho Shi Min nuk u pergjegj, keshtu qe duke dashur te zgjeroj biseden mbi kete problem i thashe se nuk eshte aspak e drejte qe nje popull e nje Parti besnike deri ne vdekje te marksizem-leninizmit, te Bashkimit Sovietik dhe te gjithë kampit socialist te trajtohen e te sulmohen ne menyre aspak te drejte. Shoku Ho Shi Min nderhyri dhe duke aprovuar besnikerine e popullit shqiptar dhe te Partise tone ndaj kauzes se socializmit tha: "do te bej nje korregjim, nje popull dhe nje Parti jo besnik deri ne vdekje te marksizem-leninizmit por besnike pergjithmone sa te jete jeta". Kjo ishte e gjithë biseda qe beri shoku Ho Shi Min gjate takimit te sipërme. Mendoj se ai nuk desheronte te zgjerohej mbi kete problem prandaj dhe evitoj zgjerimin e bisedes. Takimi gjithsej zgjati 13-15 minuta. Pas kesaj ai

./..

Viti
Dosja

I DEKLASIFIKUAR

-4-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:AT
7

u ngrit dhe me ftoj te kalojme ne nje salle tjeter per te vare se bashku me te nje film. Ne sallen ku do te çfaqej filmi veç shokut Ho Shi Min dhe mua mernin pjese personeli teknik i pallatit presidencial, njerzit e sigurimit se bashku me familjet dhe femijet e tyre, etj. Aty, ne fillim, nga ana e dy artisteve vietnameze u kendua nje kenge shqiptare e nje vendese pastaj filloj filmi artistik vietnamez. Gjate gjithë kohës shoku Ho Shi Min u tregua mjaft i ngrohet. Ne fund ai kerkoi qe ti transmetoj shume te fala shokut Enver dhe shokeve te tjere drejtuse. (Lidhur me filmin me pas mesova se shoku Ho Shi Min çdo te shtune mbrema shikon filma se bashku me personelin teknik te pallatit presidencial, dhe se ne keto çfaqje, me radhe ai fton edhe perfaqesuesit-titullaret-e vendeve mike se bashku me familjet e tyre, simbas rasteve. Ne sallen ku çfaqej filmi atmosfera ishte shume familjare, nje pjese e pjesemarrësve qe nuk kishen arritur te gjenin vend ne karrike ishen ulur ne toke kemb kryq).

2.-Sekretari i pare i Komitetit Qendror te Partise se Punonjesve te Vietnamit shoku Le Zhuen me priti ne takim, me 20 prill 1962, me ngohtesi jashtezakonisht te madhe e miqësore. Ai u interesua shume mbi gjendien ne Shqiperi sidomos per anen ekonomike. I foli hollesisht, po keshtu e vura ne dijeni mbi marrëdhëniet e Partise dhe te Vendit tone me PKBS dhe Bashkimin Sovietik. Gjate gjithë kohës qe flisja une ai degjonte me interesim te math dhe tundete koken ne shenje aprovimi per te gjitha qendrimet e Partise tone. Mbasi me degjoj, shoku Le Zhen me tha sa vijon: "Problemin ne teresi, te marrëveshjeve, une e di mire pse kam marre vete pjese ne konferencen e Bukureshtit. Neve, vazhdoi ai, kemi ndjekur dhe ndjekim me simpati te thelle e sinqerisht rrugen e lavdishme te popullit shqiptar e te Partise se Punes. Zemrat tona rrahin njelloj, nuk ka asgje qe te ndaje Partine dhe popullin tone nga Partija dhe populli tuaj".

Duke folur per veprimtarine e PP Vietnamit ne drejtim te ruajtjes se unitetit te kampit socialist shoku Le Zhuen tha: "Përjekjet tona synojne te sigurojme unitetin pse nga kjo gjendie armiqtë kane perfituar shume. Tani ka ardhur koha qe Partija Komuniste e Bashkimit Sovietik, Partija Komuniste e Kines, Partija e Punes e Shqiperise, Partija e Punonjesve te Vietnamit dhe te gjitha partite te bejne përpjekje per te dale nga kjo situatë dhe per te ndrequr gjendien. Natyrisht kjo do kohe dhe durim, ne radhe te pare duhet te

Viti
Dosja

DEKLASIFIKUAR

-5-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:6
12

krijohen konditat pozitive. Tani ka disa shenja permiresimi dhe vete sovietiket ne bisedimet qe kemi pasur me ta dhe ne letren qe na kane derguar ata shprehin nje deshire te tille". Me pas shoku Le Zhuen me foli shkurt mbi gjendien ne Vietnamin e Jugut, tha se gjendia atje paraqitet e mire dhe se luften "do ta vazhdojme me vendosmeri dhe deri ne fund". Ai falenderoj nxehtesisht Partine dhe popullin tone per mbeshtetien dhe perkrahien pa rezerva te luftes se drejte te popullit vietnamez ne Vietnamin e Jugut.

3.-Po dhe Kryeministri shoku Fam Van Dong me priti shume ngrohet, me 20 prill 1962. Edhe ai u interesua shume mbi gjendien ne Shqiperi politike dhe ate ekonomike. I foli ne menyre te permbledhur mbi gjendien si dhe unitetin e celnikte midis popullit dhe Partise, dhe se sulmeve te Hrushovit popull e Parti i jane pergjegjur duke forcuar radhet e tyre. Dhe atij i foli shkurt mbi marrredheniet me Bashkimin Sovietik. Shoku Fam Van Dong me tha sa vijon: "kemi nevojte te domosdoshme per unitetin, pse gjendia eshte keqesuar dhe vetem armiqte kane perfituar. Ne te vertete imperialistet rojne ne baze te dobeseve tona, te mungeses se unitetit, per tu permiresuar gjendia duhet durim dhe durim i math". Ai aprovonte fjalet qe i thosha une mbi qendrimin e drejte te Partise tone por evitonte te zinte me emer Hrushovin ose qfaqte mendim lidhur me politiken e PKBS. Me pas ai me foli po ne menyre te permbledhur mbi gjendien ne Vietnamin e Jugut, tha se atje "lufta vazhdon dhe do te vazhdoje dhe se bazat tona ne Vietnamin e Jugut jane shume te forta".

Shoku Fam Van Dong kerkoj ti transmetoj falenderimet me te nxehta Partise se Punes dhe Qverise tone per perkrahien e madhe dhene luftes ne Vietnamin e Jugut.

Si shokut Le Zhuen ashtu edhe shokut Fam Van Dong ne fillim i pershendeta ne emer te shokut Enver, te shokut Mehmet dhe shokeve te tjere udheheqes. Po keshtu te sipermit ne fund te takimeve me thane shume te fala per shoket tane drejtus. Shenoi se ne bisedimet me ta dhe me gjithë shoket e tjere vietnameze pata kurdohere parasysh udhezimet e Partise dhe biseda teme perqendrohej ne frymen e letres qe Partija tone i dergoj Partise se Vietnamit si dhe ne frymen e artikullit te Zerit Popullit, date 25 mars 1962.

./..

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:

DEKLASIFIKUAR

-6-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:II.-Mbi bisedimet me shoket e tjere vietnameze:

1.-Ministrin e Puneve te Jashteme,shokun Ung Van Khiem,pata rast ta takoj disa here me radhe.Ne pergjithesi ai evitonte shume bisedimet mbi mosmarreveshjet me BRSS,bile mund te thomi se ishte nje nder shoket vietnameze qe evitonte me teper se kushdo tjetër bisedat mbi revizionistet.Ne takimin e pare qe pata me te ne fillim biseda ishte e pergjitheshme,mbasandaj une e informova shkurtaz ate mbi zgjerimin e marredhenieve nderkombetare te vendit tone mbas Kongresit te 22 te PKBS dhe me kujdes kalova ku i kane sjelle marredheniet sovietiket me neve.Ai evitonte zgjerimin e bisedes dhe tregohej optimist se gjendia do te permiresohet dhe se si faze e pare duhet te pushojne sulmet ne shtyp nga te dy palet.Ne takimet qe pata me te ne pergjithesi me priti mire dhe me nje korrektese prej diplomati.

2.-Ne takimin qe pata me Zv.Kryeministrin Lue Zhue Cin,Ministrin e Tregetise se Jashteme,ate,te kultures,Ministrin e ardit,Presidentin e Asamblese Popullore dhe gjithe shoket e tjere vietnameze,me pritnin shume mire,menjher me shprehnin simpatine e madhe dhe dashurine per popullin dhe Partine tone,degjonin me vemendje shume te madhe gjithcka une iu thosha,anrovonin me nje tundje koke ose me nje"po"qendrimet e Partise tone lidhur me marredheniet me PKBS,por vete nuk shpreheshin.Dukej kjarte se te gjithe sa takova ishen te porositur mbi biseden qe do te benin me mua pse te gothuajse te gjithe te njejtat fjale thoshin:E fillonin nga korri i ushtrise tone qe kishte lene pershtypie shume te mbedha ne Vietnam,flisnin me simpati te madhe per popullin e Partine tone,nenvizonin nevojen e unitetit,falenderonin per perkrahien luftes se tyre ne Vietnamin e Jugut,etj.Emrin e Hrushovit shume rralle e zinin me goje.Ministri i Tregetise se jashteme me tha:"neve mendojme njelloj,asgje nuk na luan nga rruga tone e perbashket,le te thone qte duan te tjeret,ne imperialistet i kemi te dera dhe do leftojme me vendosmeri kundra tij".

Per te kuptuar me mire gjendien,gjate qendrimit ne Vietnam,si une ashtu edhe shoku Xhafer Bakllamaja,biseduam edhe me njerez te thjeshte,jo vetem kuadro te larta.Kudo dhe cilin do qe takuam u shpreh shume mire per Partine tone dhe Shqiperine si anetar e denje e kampit socialist.Me poshte japim disa

./..

Viti:
Dosja:MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:
DEKLASIFIKUAR

-7-

shembuj konkret:Zv.Drejtori i nje instituti te larte arsimesor i foli hapet sh.Xh.Bakllamaja kunder politikes se Hrushovit,(per kete te shihet informacioni i veçante)/.Zv.Drejtori i portit te Haifongut me tha se "shume drejte ka venruar Partija tuaj kundrejt politikes se Hrushovit,edhe ne po te ishim ne vendin tuaj po ashtu do te vepronim".

Shoferi i automobilit qe na kishen vene ne dispozicion,i cili duhej te ishte kuader i sigurimit pse kishte mjaft zhvillim,kish marre pjese ne kurse partiye dhe dhe partizan per nende vjet me radhe,mbassi i folem per revizionizmin tha"Neve problemi ne Parti nuk na eshte skjaruar gjeresisht,masa e Partise ceshtien akoma nuk e ka mire te kjarte,udheheqia i di mire gjithë problemet por neve jo.Ne Parti na eshte thene shkurt se çka ndodhi ne Kongresin e 22 jane mos-marreveshje midis vellezerve dhe qe do te zgjidhen,pyetje nuk jane lejuar.Une,vazhdoi i sipermi,fjalimin e shokut Enver e kam degjuar te transmetuar nga radio Saigoni"Pastajme revoltim shtoj"une jam dakord me shokun Enver,keshtu jane dhe gjithë komunistet e tjere dhe njerzit e thjeshte. Edhe sikur te kete gabim nuk mund te trajtohet keshtu vellaj i vogel,duke e vrare me gjithse nuk ka faj".Edhe per ndihmat qe Bashkimi Sovietik i jete Naserit,Nehruit,Sukarnos,etj.fliste me revoltim:"iu jep atyre tha,kurse ne ketu pas kaq vjetesh lufte dhe sakrifica jemi ne gjendie akoma shume te varfer.Ne marrim vetem nje kostum te lehte,dok,ne vit,dhe per te blere nje biciklete na duhet te kursejme tre vjet me radhe".Problemi i ndihmes dukeq te ishte diskutuar dhe me te tjete,ne kete drejtim çfaqej nje pakenaqesi e pergjitheshme.Pati raste qe dhe shoke te tjere vietnameze ma permenden;duke thene se ekonomikisht nuk jemi mire ata shtonin se kjo gjendie veshtiresohet pse tani duhet te çlyejme brenda nje permudhe te shkurter dhe borxhet,d.m.th.ato qe i kane Bashkimit Sovietik.

Eshte karakteristike te shenohet se edhe me njere te thjeshte qe takuam ne qendra pune ose edhe rstesisht ne nje park,te gjithë flisnin shume mire dhe me simoati per Shqiperine,por pergjithesisht per divergjencat ne lëvizjen komuniste nderkoebetare dhe per karakterin e tyre ishen shume pak te informuar.E vetmia pike qe ata flisnin hapet dhe pa rezerva ishte lufta kundra imperialismit amerikan.

./..

VIII
Dosja

DEKLASIFIKUAR

-8-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:

III.-Disa konkluzione:

1.-Ne pergjithesi masa e Partise dhe populli vietnamez, me gjithë sulmet ne Kongresin e 22 te PKBS, vazhdon te kete nje mendim shume te drejte mbi Partine e Punes dhe vendin tone. Ne ditet qe zhvillonte punimet Kongresi i 22, ne Parti e ne popull pati nje fare diziluzioni, kjo per faktin se ato nuk dinin gje me pare se q'po ngjiste ne levizjen komuniste nderkombetare. Ne ato dite Radio Moska transmetonte ne gjuhen vietnameze sulmet e Hrushovit kundra Partise dhe vendit tone, por fill mbas kesaj, fillonte Radio Pekini e cila transmetonte materiale, po ne gjuhen vietnameze, tjeter per tjeter nga ajo te transmetuara nga Radio Moska. Megjithë situaten e rende, prape Partija nuk beri skjarime te gjera por, u kufizua ne shpjegime te thjeshta. Persa i perket kuadrove duket se skjarimet u bene menjehere, ne fryman e "pajtimit dhe te ruajtjes se unitetit".

Me pas e verteta, ne menyre te hollesishme u mesua nga gazeta "Zhen Min Zhi Bao", me fjalimir e shokut Enver si dhe me materialet e tjera te Partise tone. Po keshtu nga materialet qe dergoj, ne shumice, Ambasada tone si dhe nga ato te shperndara nga ana e Ambasades kineze ne Hanoi. Shoket kineze me thane se, ne ato dite, nje numur i math personash u drejtua ne Ambasadeb e tyre per te marre materiale nga tonat ose huanin "Zhe Min Zhi Baon". Nga materialet tona shoket vietnameze ne shtypin e tyre nuk botuan asgje. Fjalimi i shokut Enver dhe artikujt e tjere te "Zeri i Popullit", nga se mesuam, jane perkthyer ne gjuhen vietnameze dhe iu jane dhene per lexim vetem kuadrove. Kjo pune eshte bere ne sekret, pothuajse te plote, dhe qe kopjet e shaptilografuara te mos binin ne dore te mases ose te sovietikeve. I ngarkuari me pune a.i. kinez e mesoj vetem nga une faktin qe fjalimi i shokut Enver eshte perkthyer e shperndare kuadrove per lexim, te pakten keshtu me tha.

Per botimin e fjalimit te shokut Enver ne gjuhen vietnameze na tha nje student toni, i cili e kishte pare vete, ia kish treguar ne konfidence nje kuader vietnamez. Po keshtu me tha zv.kryetari i Komitetit per marredhenie kulturele si dhe zv.kryetari deges shtypit te Ministrise se Jashteme. Sh.Xh/Bakllmaja i tha nje zv.drejtor i nje instituti te larte arsimor.

./..

MPJ ARKIV

111
isjw Flet

DEKLASIFIKUAR

-9-

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja № Fleta:

2.-Nga konstatimet qe patem gjate qendrimet ne Vietnam, duket kjarte se ne esence Partija e Punonjesve te Vietnamit nuk aprovon ne asnje menyre sulmet e drejtuara nga Kongresi i 22 kunder Partise tone, dhe se ajo kupton mire demin e math qe po i sjellin revizionistet levizjes komuniste e punetore ne teresi. Kjo duket dhe ne faktin se marredheniet e RD Vietnamit me Bashkimin Sovietik nuk jane me fazen e mepareshme, tani ato jane ftohur. Me gjithë kete, atje egziston akoma e forte "fryma e pajtimit dhe uniteti me çdo kusht", pa peshuar mire se mbi çbaze duhet te sigurohet ky unitet, kjo nuk mund te thuhet se egziston ne te gjitha kuadrot.

3.-Qendrimi i Partise se Punonjesve te Vietnamit kundrejt divergjencave ne teresi, ka influencuar edhe ne zhvillimin ne nje shkalle me te ulet te marredhenieve shteterore midis Vietnamit dhe Bashkimit Sovietik. Ne gjithë bisedimet shoket vietnameze evitonin absolutisht te flitnin mbi marredheniet e tyre me Bashkimin Sovietik. Egziston nje fryme e forte "te mos prishemi me Bashkimin Sovietik", "te mos keq-kuptohemi nga ta". Ne bisedim me kryetarin e deges se vendeve socialiste te Ministrise se Puneve te Jashteme mbi mundesine e hapies se perfaqesive te perhereshme te te dy vendeve reciprokisht ne Tirane e Hanoi, ai me tha se prej kohesh ata donin te hapnin ambasadën e tyre ne Tirane por, me qene se ndodhen mos-marreveshjet, "nuk vepruam se mos keq-kuptohet nga te tjeret dhe se do ta hapim me tu normalizuar gjendia". Une i thashe te sipermit se nuk ka rendesi "puna edhe keshtu behet, megjithate ç'puna kane ketu te tjeret juve jeni shtet independent dhe nuk pyesni njeri se ku do hapni ose jo perfaqesi". I sipermi e pa qe e shkeli, me tha nje sekret te tyre, dhe nuk e zgjati. Shenoi se shoku Ho Shi Min po per kete qeshite me tha se "ne jemi shtete te vegjel dhe nuk perballojme dot shpenzimet e shumta te perfaqesive"; une nuk i thashe asnje fjale.

Po ne kete kuader -kompromisi-, "te mos keq kuptohemi", mund te shpjegohet edhe fakti qe mua nuk me prit Presidenti me rastin e dorezimit te kredencialeve por Zv. Presidenti, dhe ne fund te fundit "praktika" ne rastin e marredhenieve midis vendeve miq mund te lihej me njane. Po keshtu ne kete kuader mund te shpjegojme edhe qendrimin e tyre qe nga njera ane me presin shume ngrohjet nga ana tjeter fjalimi i Zv. Presidentit, qe do botohej publikisht nuk i pergjigjej

./..

Viti
Dosja# Fle

DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja# Fleta:

12

-11-

Lidhur me sa me siper, mendojme se edhe Ambasadori i Vietnamit,
ne rastin me te pare qe do te vije ne Tirane te jete mik i pales tone
per ditet qe do te qendroje aty.

Persa shkruajme ne kete relacion ne rast se keni ndo nje vrejttje
ose udhezim, lutemi na njoftoni.

Ambasadori
(Reis Malile)

Pekin 2 maj 1962